



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

Mr. 2899 Prot

VENDIM

Dt. 14.10.2020

NR. 96, DATË 14.10.2020

MBI

SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË “RADIO TELEVISIONI SARANDA” SH.P.K., PËR RISHIKIMIN E VENDIMIT NR. 60, DATË 21.08.2020 TË AMA-S “PËR SHQYRTIMIN E APLIKIMIT TË SHOQËRISË “RADIO TELEVISIONI SARANDA” SH.P.K., PËR MARRJE LICENCE TRANSMETIMI AUDIO PRIVATE LOKALE PËR SUBJEKTIN AUDIO “SARANDA IME RADIO”

Autoriteti i Mediave Audiovizive, i përbërë nga:

Gentian	Sala	Kryetar
Sami	Nezaj	Zëvendëskryetar
Agron	Gjekmarkaj	Anëtar
Gledis	Gjipali	Anëtar
Suela	Musta	Anëtar

pasi mori në shqyrtim çështjen që i përket palëve:

Kërkues: Shoqëria “Radio Televizioni Saranda” sh.p.k.

Objekt: Rishikimi i vendimit nr. 60, datë 21.08.2020 të AMA-s “Për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “Radio Televizioni Saranda” sh.p.k., për marrje licence transmetimi audio private lokale për subjektin audio “Saranda Ime Radio”.

Bazë Ligjore: Neni 19, pika 16 të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nenet 113 dhe 136, pika 4 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”

VËREN:

Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA) në mbështetje të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, rregullores “Për procedurat dhe kriteret për dhënien e licencës së transmetimit audio”, miratuar me vendimin e AMA-s, nr. 153, datë 18.07.2016, të ndryshuar, si dhe vendimit nr. 43, datë 29.05.2020 të AMA-s “Për përcaktimin e frekuencave për shërbimin e transmetimit audio analoge dhe çeljen e garës për dhënien e licencës të transmetimit audio analoge”, çeli garën e përzgjedhjes së kandidaturave për dhënien e licencës të transmetimit audio analoge në zonën Bashkia Sarandë.

Në vijim të njoftimit të AMA-s për çeljen e garës publike, shoqëria "Radio Televizioni Saranda" sh.p.k., depozitoi aplikimin nr. 1938 prot., datë 13.07.2020, për marrje licence transmetimi audio private lokale "Saranda Ime Radio".

Aplikimi i subjektit rezultoi i plotë dhe në përputhje me kërkesat dhe kriteret e parashikuara në rregulloren e cituar më sipër dhe Komisioni i Shqyrtimit të Dokumentacionit (KSHD), i propozoi AMA-s dhënien e licencës private lokale të transmetimit audio analoge, shoqërisë "Radio Televizioni Saranda" sh.p.k., për subjektin audio "Saranda Ime Radio", për të mbuluar me sinjal audio, Bashkinë Sarandë.

Pasi mori në shqyrtim aplikimin e subjektit, AMA me vendimin nr. 60, datë 21.08.2020, vendosi rrëzimin e aplikimit dhe mosdhënien e licencës së transmetimit audio private lokale shoqërisë "Radio Televizioni Saranda" sh.p.k., për subjektin audio "Saranda Ime Radio". Shkak i kësaj vendimmarrjeje ishte mungesa e arritjes së kuorumit të nevojshëm ligjor për lëshimin e licencës së transmetimit, prej 5 votash.

Në nenin 13 të ligjit organik, parashikohet se: *"2. Vendimet e AMA-s merren kur për to votojnë pro shumica e anëtarëve të pranishëm, me përjashtim të rasteve të parashikuara ndryshe në këtë ligj."* Ndërsa në nenin 19 të po këtij ligji, parashikohet se AMA lëshon dhe heq licencat dhe/ose autorizimet me shumicë të cilësuar.

Neni 25 i rregullores së Autoritetit të Mediave Audiovizive, miratuar me vendimin e AMA-s nr. 209, datë 16.09.2016, i ndryshuar, përcakton se: *"Autoriteti i Medias Audiovizive, i merr vendimet me shumicën e votave të anëtarëve që janë të pranishëm në mbledhje, me përjashtim të rasteve kur në ligj parashikohet shumicë e cilësuar."*

Në mbledhjen e AMA-s të datës 21.08.2020, kur është miratuar edhe vendimi për shqyrtimin e aplikimit të palës kërkuese, kanë qenë të pranishëm 5 anëtarë dhe ndarja votive ka rezultuar:

- 4 anëtarë kanë qenë pro dhënies së licencës për subjektin aplikues;
- 1 anëtar, nuk ka marrë pjesë në votim, duke abstenuar.

Në marrjen e vendimit për rrëzimin e aplikimit dhe mosdhënien e licencës për shoqërinë "Radio Televizioni Saranda" sh.p.k., AMA argumentoi se në kushtet kur AMA është organ kolegjal i përbërë nga Kryetari dhe 6 anëtarë, për të miratuar dhënien e licencës së transmetimit audio private lokale nevojitet një shumicë e cilësuar prej 5 votash, shumicë, e cila eventualisht, mund të arrihet/plotësohet edhe pse AMA aktualisht funksionon dhe ushtron aktivitetin e tij administrativ dhe vendimmarrës me 5 anëtarë, pra jo me anëtarësi të plotë (pasi 2 vende janë vakante).

Shoqëria "Radio Televizioni Saranda" sh.p.k., pasi është njohur me vendimin nr. 60, datë 21.08.2020, "Për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë "Radio Televizioni Saranda" sh.p.k., për marrje licence transmetimi audio private lokale për subjektin audio "Saranda Ime Radio" ka depozituar kërkesën, administruar në AMA, me nr. 2512/1 prot., datë 16.09.2020, për të rishikuar vlerësimin për aplikimin për licencën e transmetimit audio private lokale "Saranda Ime Radio".

Në këtë kërkesë, shoqëria "Radio Televizioni Saranda" sh.p.k., parashtron:

"... AMA nuk ka asnjë vërejtje apo konstatim shkelje në aplikimin tonë, siç edhe është shprehur në vendimin e datës 21.08.2020 me nr.60 (bazuar edhe në përmbajtjen e shkresës që më keni dërguar ...

Ne presim që në zbatim të ligjit nr. 97/2013, i ndryshuar, të diskutohet, vlerësohet dhe votohet mbi aplikim tonë, në kushtet kur plotësohet kuorumi i nevojshëm....”.

AMA vëren se shqyrtimi i kërkesës së paraqitur nga shoqëria “Radio Televizioni Saranda” sh.p.k. është në kompetencë të AMA-s, në kushtet që kemi të bëjmë në thelb me ankim administrativ.

Në nenet 134 dhe 136 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, në mënyrë të shprehur parashikohet e drejta e subjektit të interesuar për t’iu drejtuar me ankim organit publik që ka nxjerrë aktin ose që ka në kompetencë të nxjerrë aktin, si dhe e drejta/detyrimi i organit publik për të shqyrtuar në radhë të parë ankimin ndaj aktit administrativ.

Për sa më sipër, në kushtet kur vetë ligji organik nr. 97/2013, nuk parashikon në mënyrë të shprehur një procedurë të ndryshme ankimi ndaj aktit administrativ të kundërshtuar nga kërkuesi, shoqëria “Radio Televizioni Saranda” sh.p.k., duke mos përjashtuar kështu të drejtën e tij për t’iu drejtuar fillimisht me ankim organit administrativ që ka nxjerrë aktin, AMA, ka në kompetencë të marrë në shqyrtim kërkesën e paraqitur nga subjekti i interesuar.

Në vijim, AMA vlerëson të marrë në shqyrtim çështjen e kompetencës për të anuluar ose shfuqizuar një akt administrativ të nxjerrë prej tij si dhe respektimin e afateve ligjore të paraqitjes së kërkesës nga subjekti i interesuar, në rastin konkret të shoqërisë “Radio Televizioni Saranda” sh.p.k.

Ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” në fuqi, në Seksionin 3 “Ligjshmëria, pavlefshmëria dhe korrigjimi i aktit administrativ” ka parashikuar rastet se kur një akt administrativ do të konsiderohet i ligjshëm, kur do të konsiderohet si absolutisht i pavlefshëm, si dhe rastet e paligjshmërisë. Gjithashtu në këtë seksion, ndër të tjera, Kodi i Procedurave Administrative ka parashikuar procedurat dhe mjetet ligjore që mund të ndiqen e përdoren nga vetë organi administrativ, organi i tij epror, apo palët e interesuara për të konstatuar paligjshmërinë e një akti, korrigjimin e tij, si dhe pasojat e tyre.

Kështu, në nenin 113/1 të K.Pr.Administrative parashikohet se: “ 1. *Një akt administrativ mund të anulohet apo shfuqizohet, kryesisht nga organi publik që ka kompetencë të nxjerrë aktin, nga organi i tij epror apo nga një organ tjetër i parashikuar shprehimisht me ligj.* 2. *Anulimi i një akti administrativ ka pasoja për të shkuarën, ndërsa shfuqizimi i aktit administrativ ka pasoja vetëm për të ardhmen. Anulimi dhe shfuqizimi mund të jenë të pjesshëm apo të tërësishëm.* 3. *Anulimi ose shfuqizimi bëhen me një akt të ri me shkrim, i cili anulon, shfuqizon, ndryshon apo plotëson aktin e parë.*

Në analizë të sa më sipër, AMA, si organ administrativ ka në kompetencë të saj të anulojë apo shfuqizojë aktet administrative të nxjerra prej saj në rastet kur vërtetohen kushtet e parashikuara nga ligji, siç është paligjshmëria e aktit, nëse konstatimi i rrethanave bëhet brenda afateve ligjore të sipërcituara.

AMA konstaton se abstenimi nga votimi i një prej anëtarëve të AMA-s, bie ndesh me parashikimet e ligjit nr. 8480, datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, konkretisht nenin 12, të tij që parashikon Votimin e detyrueshëm. Sipas këtij neni: “Anëtarët e organit kolegjial, qe janë te pranishëm ne mbledhje dhe qe nuk kane ndonjë pengese ligjore për te votuar, nuk mund te abstenojnë, përveç

organeve te zgjedhura dhe kur parashikohet ndryshe nga ligji. Kryetari i organit kolegjal voton i fundit.”.

Për sa u trajtua më lart, AMA merr në konsideratë ankimin e paraqitur nga subjekti,

PËR KËTO ARSYE

Autoriteti i Mediave Audiovizive, në bazë të nenit 19, pika 16 të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neneve 113, 136 pika 4 të ligjit nr. 44/2015 Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”

V E N D O S I:

1. Pranimin e ankimit administrativ të paraqitur nga shoqëria “Radio Televizioni Saranda” sh.p.k., duke vendosur shfuqizimin e vendimit nr. 60, datë 21.08.2020 të AMA-s “Për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “Radio Televizioni Saranda” sh.p.k., për marrje licence transmetimi audio private lokale për subjektin audio “Saranda Ime Radio”.
2. Dhënien e licencës private lokale të transmetimit audio analoge, shoqërisë “Radio Televizioni Saranda” sh.p.k., me NIPT: M04301804A dhe administrator: Thodhori Dukshi, të përbërë nga licenca e shërbimit të programit audio “Saranda Ime Radio” dhe licenca për ndërtimin e operimin e rrjetit analog, për të mbuluar me sinjal audio, “Bashkinë Sarandë” për një periudhë prej 5 vjetësh me karakteristikat teknike të transmetimit sipas Aneksit nr. 1, bashkëlidhur.
3. Ngarkohet administrata e AMA-s për veprime të mëtejshme sipas ligjit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetar:

Gentian

SALA

Zëvendëskryetar:

Sami

NEZAJ

Anëtarë:

Agron

GJEKMARKAJ

Gledis

GJIPALI

Suela

MUSTA

ANEKSI NR. 1

1. Parametrat teknikë të pikës së transmetimit Kala Lëkurs:

Pika e transmetimit	Freq MHz	Koordinatat X Y Z	Fuqia Nominale (W)	Gain (dBi)	ERP (W)	Azimuth (°)	Lartësia e antenës (m)	Drejtimi i antenës
Kalaja Lëkurs	107.4	20.013266 39.515717 250 4DMS	200	6	385.64	250	10	D